



UT - Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Republika e Maqedonisë së Veriut
УТ - Факултет за Медицински науки - Република Северна Македонија
Nr.-Бр. 22-1684/1
18.06 2026 vit/год.
Tetovë - Тетово

UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/'18, 178/'21, 58/'24), Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe Udhëzuesin me kriteret për realizimin e zgjedhjeve për anëtarët dhe për kryetarin e Kuvendit Studentor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, shpallet:

KONKURS

për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore

- I. Të drejtë për të aplikuar kanë të gjithë studentët që e kanë regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2025/2026, duke përfshirë edhe studentët që kanë regjistruar semestër veror të zbrazët në vitin akademik të lartpërmendur.
- II. Së bashku me Fletaplikimin (formularin), kandidatët dorëzojnë:
 - biografi (CV),
 - vërtetim nga shërbimi për çështje studentore se kandidati e ka regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2025/2026,
 - vërtetim për notë mesatare prej së paku 8 për kandidatin për kryetar, i cili do të zgjidhet në mbledhjen e parë të Kuvendit Studentor të Fakultetit.
- III. Kandidatët për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit janë të detyruar që personalisht t'i dorëzojnë fletaplikimet me dokumentet përkatëse, përmes arkivit të Fakultetit ose me postë në adresën: rr. "29 Nëntori", 1200, Tetovë, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga shpallja e njoftimit, respektivisht më së voni deri më 26.06.2026 në ora 16:30.
- IV. Aplikimet e vonuara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.



Kryetar i Komisionit Zgjedhor

Prof. dr. Muhamed Tairi

Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Факултет за Медицински науки - Faculty of medical sciences

Rd.29 November, nn. 73, 1200 Tetova, Republic of North Macedonia

www.unite.edu.mk – e-mail: medscience@unite.edu.mk